

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7060  
E premte, 1 dhjetor 2023  
Çmimi 0.50 €

Kërkohet sërish shtyrja  
e afatit për reregjistrimin  
e makinave në veri FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## PUSHTETI E LAVDËRON RAPORTIN E PROGRESIT, OPOZITA THOTË SE ËSHTË NDËR RAPORTET MË TË DOBËTA PËR KOSOVËN



Në Kuvendin e Kosovës të enjten është diskutuar për Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2023 nga Komisioni Evropian. Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, ka

thënë para deputetëve se raporti konstaton se qeveria ka vazhduar agjendën e saj ambicioze të reformave drejt BE-së. Ndërkaq deputetët e opozitës kanë theksuar raporti i sivjetmë i KE-së është ndër raportet

më të dobëta ndonjëherë për Kosovën, pasi për shumicën e sektorëve janë dhënë vërejtje dhe, sipas opozitës, qeveria Kurti po vazhdon të bëjë politikë të gabuar në raport me BE-në

### AKTUALE



**VDIQ ISH-SEKRETARI AMERIKAN I SHTETIT, HENRY KISSINGER** F. 2

**PËRSE KOSOVA NUK ËSHTË PJESË E OSBE-SË?** F. 7

**PSD-ja KËRKON LIRIMIN E AKTIVISTËVE, OFRON DËSHMI PËR DHUNËN DHE ARMËT E PËRDORURA NGA POLICIA** F. 6

### EKONOMI



**AKP-JA RIMERR DISA ASETE NË MAL TË ZI** F. 8

**KURTI: INDUSTRIJA E DRURIT, SEKTOR STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS** F. 8

### SPORT



**RAMADANI PARAQITET TE DRITA: SYNOJMË TITULLIN** F. 10

### ZJARRFIKËSIT NË KOSOVË KËRKOJNË KUSHTE MË TË MIRA TË PUNËS



**BISLIMI: TENTIMI PËR TË ORGANIZUAR ZGJEDHJE SERBE NË KOSOVË PA KËRKESË NUK ËSHTË NË FRYMËN E DIALOGUT** FAQE 5



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
+377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Vdiq ish-sekretari amerikan i Shtetit, Henry Kissinger

WASHINGTON, 30 NËNTOR - Ish-sekretari amerikan i Shtetit, Henry Kissinger, ka vdekur në moshën 100-vjeçare, ka njoftuar kompania konsulente e tij të mërkurën. Ai ka vdekur në shtëpinë e tij në Konektikat. Kissinger kishte dominuar në politikën e jashtme përdorur Shtetet e Bashkuara u larguan nga lufta në Vietnam dhe larguan barrierat me Kinën. Kissinger kishte ndikim të madh në çështjet globale gjatë shërbimit të tij në mandatet presidenciale të Richard Nixonit dhe Gerald Fordit, duke fituar edhe ÇMIMIN Nobel për Paqe. Fuqia e Kissingerit u rrit gjatë trazirave të shkaktuara nga afëra Watergate, kur ai mori një rol të ngjashëm me të bashkëpresidentit, në kohën kur fuqia e Nixonit ishte dobësuar për shkak të aferës.

Një hebre që u largua nga Gjermania Naziste së bashku me familjen e tij, Kissinger në vitet e mëvonshme fitoi reputacionin e një burrështetasi të respektuar, duke ofruar këshilla si për republikanët ashtu dhe për demokratët. Në shumë raste ai u pa edhe në Shtëpinë e Bardhë në kohën kur Donald Trumpi ishte president.

Për tetë vjet fillimisht si këshilltar për siguri kombëtare, më vonë si sekretar i Shtetit dhe për një periudhë duke mbajtur të dyja këto pozita, Kissingeri kishte trajtuar çështjet kryesore të politikës së jashtme. Ai kreu "diplomacinë e parë fluturuese" në kërkim të paqes në Lindjen e Mesme. Ai përdori kanale sekrete për të krijuar lidhje midis ShBA-së dhe Kinës, duke u dhënë fund



dekadave të izolimit dhe armiqësisë së ndërsjellë. Kissingeri, po ashtu, kishte nisur negociatat e Parisit për ta nxjerrë ShBA-në nga një luftë e kushtueshme në Vietnam. Ai, po ashtu, ndoqi një politikë për t'i ulur tensionet me Bashkimin Sovjetik që çoi në marrëveshje për kontrollin e armëve dhe hapi mundësitë që tensionet e Luftës së Ftohtë dhe kërcënimeve bërthamore të mos zgjasnin përgjithmonë.

Gjatë një interviste dhënë në korrik të vitit 2022 për ABC ai u pyet nëse do të dëshironte të ndryshonte ndonjë nga vendimet e ndërmarra gjatë

karrierës së tij. "Kam menduar për këto probleme gjatë gjithë jetës sime. Është hobi im, por edhe profesioni im. Prandaj, rekomandimet që bëra ishin më të mirat për të cilat atëherë isha i aftë t'i bëja", kishte deklaruar Kissingeri.

Deri në muajt e fundit të jetës së tij, Kissingeri u përfshi në çështje globale. Në korrik ai u takua me liderin kinez Xi Jinping në Pekin. Dhe 50 vjet pasi diplomacia fluturuese e tij ndihmoi në dhënien fund të Luftës së Lindjes së Mesme të vitit 1973, kur Izraeli zmbrapsi sulmet e befasishme nga Egjipti dhe Siria, Kissingeri kishte paralajmëruar se konflikti

mund të përsëritej, pasi Izraeli u përball me sulm të befasishtë nga Hamasi - grup palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja më 7 tetor.

Kissingeri fitoi Çmimin Nobel për Paqe për shkak të marrëveshjes së armëpushimit arritur më 1973.

## Zyrtarët në mbarë botën nderojnë Kissingerin

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, tha se Kissingeri "krijoi me të vërtetë standardin për të gjithë ata që ndoqën këtë punë" dhe se ai ishte "shumë i

privilegjuar që të merrja këshillën e tij shumë herë, duke përfshirë edhe një muaj më parë". "Pak njerëz ishin studentë më të mirë të historisë", tha ai. "Edhe më pak njerëz bënë më shumë për ta formësuar historinë sesa Henry Kissinger", tha ai.

Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, e quajti Kissingerin "një njeri i sjellshëm dhe një mendje brilante, i cili për mbi 100 vjet u dha formë fateve të disa prej ngjarjeve më të rëndësishme të shekullit". "Një strateg me vëmendje deri në detajet më të vogla", tha Michel. Presidenti francez Emmanuel Macron shkroi në "X", se "Henry Kissinger ishte një gjigant i historisë. Shekulli i tij i ideve dhe i diplomacisë pati një ndikim të qëndrueshëm në kohën e tij dhe në botën tonë".

Edhe udhëheqësit e Gjermanisë, vendit të lindjes së Kissingerit, e përkujtuan ish-diplomatit, i cili ishte hebre, dhe ishte larguar së bashku me familjen nga Gjermania Naziste kur ishte adoleshent. "Angazhimi i tij për miqësinë transatlantike midis ShBA-së dhe Gjermanisë ishte i rëndësishëm dhe ai mbeti gjithmonë pranë atdheut të tij gjerman", shkroi kancelari gjerman Olaf Scholz në "X".

Presidenti izraelit Isaac Herzog, gjatë takimit me sekretarin Blinken në Tel Aviv, pati thënë se Kissingeri "vuri gurin e themelimit të marrëveshjes së paqes, e cila u nënshkrua më vonë me Egjiptin, dhe shumë procese të tjera në mbarë botën që unë i admiroj". Kissinger ka lënë pas dy fëmijë, Elizabeth dhe David.

# Kovaçevski: Lufta në Ukrainë po i rrënon themelet e OSBE-së

SHKUP, 30 NËNTOR - Në Shkup të Maqedonisë së Veriut të enjten ka nisur punimet samiti i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

Kryeministri maqedonas, Dimitar Kovaçevski, në hapje të punimeve të samitit, është përqendruar në sfidat me të cilat është përballuar OSBE-ja pas agresionit të paprovokuar të Rusisë kundër Ukrainës. "Ne kemi kryesuar vitin më të vështirë për OSBE-në, duke pasur parasysh se organizata është përballur me një sërë sfidash në dritën e agresionit të pajustificuar të Rusisë kundër Ukrainës. Por, shpresoj që do të arrijmë t'i miratojmë vendimet për ta zgjedhur kryesuesin e ri dhe katër pozicionet më të rëndësishme në OSBE, si dhe buxhetin për funksionimin e

organizatës", ka thënë Kovaçevski, teksa ka vënë theksin te takimi gjatë së mërkurës me sekretarin amerikan të Shtetit, Antony Blinken, dhe me ministrin e Punëve të Jashtme të Britanisë, David Kamerun. "Duhet të jemi të vetëdijshëm se çdo vend në mënyrën e vet dërgon mesazhe për agresionin e pajustificuar të Rusisë kundër një shteti sovran në Ukrainë. Disa vende e bëjnë këtë me mungesën e tyre dhe disa me pikëpamje të shprehura qartë", ka thënë Kovaçevski.

Ai ka shtuar se agresioni rus kundër Ukrainës ka vazhduar "me intensitet të lartë dhe me pasoja të rënda dhe shkatërruese duke konfirmuar padrejtësinë e saj". "Çdo ditë që kalon dhe çdo jetë e humbur po dëshmon ashpërsinë e agresionit dhe aktin e shkeljes



flagrante të sovranitetit dhe të kartës së Kombeve të Bashkuara, parimet dhe angazhimet e OSBE-

së, para së gjithash vlerat njerëzore. Populli i Ukrainës meriton paqe dhe lufta duhet të ndërpritet. Arritja

e paqes mbetet imperativ. Kjo luftë po vazhdon t'i rrënojë themelet e OSBE-së", ka deklaruar Kovaçevski.

# Zjarrfikësit në Kosovë kërkojnë kushte më të mira të punës

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 30 NËNTOR** - Zjarrfikësit e Kosovës protestuan më 30 nëntor para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar nga ekzekutivi t'i përmirësojë kushtet e tyre të punës të cilat i cilësuan "të rënda".

Kryetari i Sindikatës së Zjarrfikësve të Kosovës, Muharrem Beka, ka thënë se punonjësit e këtij institucioni përballen me shumë probleme. Ai kërkoj që Qeveria e

Kosovës t'i takojë përfaqësuesit e zjarrfikësve në mënyrë që të diskutohet për kërkesat e tyre. "Zjarrfikësit e Kosovës ballafaqohen me një mori problemesh të padefinuara, pa buxhet të planifikuar dhe pa pajisje, edhe personale, edhe kolektive, numër të vogël të zjarrfikësve që ndikon në aftësitë tona, mosha mesatare e kështu me radhë. Zjarrfikësit nuk e kanë vendin në protestë. Zjarrfikësit janë themeluar për shpëtimin e jetës së njerëzve dhe të mirave materiale",



ka thënë Beka, duke shtuar se pakënaqësitë e zjarrfikësve janë të akumuluar ndër vite.

Ai ka theksuar se kërkesat e tyre janë që të sigurohet një buxhet emergjent shtesë, pasi tha se, sipas ligjeve në fuqi, buxheti i zjarrfikësve u ka mbetur në kompetencë komunave.

Zjarrfikësit, sipas tij, kërkojnë të shqyrtohet vendimi për largimin e rrezikshmërisë në punë dhe të nisë

kompensimi i rrezikshmërisë nga shkurti në mënyrë retroaktive.

Ndër kërkesat e tjera të zjarrfikësve janë edhe pagesa e orëve jashtë orarit për vitin 2022 pasi, sipas Bekës, ato nuk janë paguar, por edhe të vitit 2023. "Disa komuna kanë filluar t'i kompensojnë dhe disa jo", ka thënë Beka.

Zjarrfikësit, po ashtu, kërkojnë pajisje mbrojtëse dhe që ata të trajtohen në mënyrë të

dinjitetshme.

Në Kosovë janë rreth 800 zjarrfikës. Në bazë të rregullores për strukturën organizative të njësive profesionale të zjarrfikësve dhe shpëtimin, për çdo 1 500 banorë nevojitet së paku një zjarrfikës.

Në bazë të kësaj llogaritjeje, Kosova duhet të ketë rreth 1 200 zjarrfikës. Zjarrfikësit nuk kanë sigurime shëndetësore dhe paga e tyre bazë është 520 euro.

## Ahmeti: Mostrajtimi adekuat i detyron zjarrfikësit të protestojnë në rrugë

Tahir Ahmeti, njohës i çështjeve të emergjencave, njëherësh drejtor ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politikën e Sigurisë (SPRC), ka shkruar në rrjetet sociale se mostrajtimi adekuat i detyron zjarrfikësit të protestojnë në rrugë.

Ahmeti ka theksuar se kërkesat e zjarrfikësve, janë të drejta, të arsyeshme dhe të mbështetura

në ligj. "Problemet evidente të grumbulluara me vite të tëra, sigurisht se shkaktojnë indinjatë dhe revoltë te kjo kategori punëtorësh. Protestat nuk janë zgjedhje e duhur, por mostrajtimi adekuat dhe serioz i këtij mekanizmi, padyshim që i detyron ata për ndërmarrjen e veprimeve të tilla. Qeveria duhet të reflektojë mbi kërkesat e tyre!", ka thënë Ahmeti.

# Rreth 1/5 e popullsisë së lindur në Ballkanin Perëndimor jeton jashtë vendit

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 30 NËNTOR** - Ballkani Perëndimor renditet ndër disa prej ekonomive më të prekura nga ikja e trurit, me pritshmëri për të humbur rreth një milion të rinj në dekadën e ardhshme. Njerëzit që largohen nga rajoni jo vetëm që përbëjnë rrezik për disponueshmërinë e fuqisë punëtore, por janë kërcënim shtesë ndaj kujdesit shëndetësor dhe sistemeve të pensioneve në rajon. Nëse këto parashikime do të realizohen, Ballkani Perëndimor mund të bëhet shumë shpejt një rajon i plakur, duke na bërë të kemi nevojë të vazhdueshme për burime shtesë.

Në këtë edicion të #TalkingPoint, sekretarja e përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Majlinda Bregu, ka folur për kapitalin njerëzor dhe të gjitha pengesat që pasojnë prej ikjes masive të trurit të Ballkanit Perëndimor, duke hapur kështu një diskutim se çfarë mund të bëhet në nivelin personal dhe atë institucional.

U tha se fillimi mund të jetë krijimi i një mendësie të re për migracionin, rishfrytëzimin e emigrimit, por edhe krijimi i politikave të reja kombëtare dhe rajonale rinore, të krijuara për të çmuar dhe vlerësuar edhe më shumë njerëzit e rinj dhe të aftë

nga rajoni ynë. "Numrat e vështirë s'është e lehtë të arrihen, por ja që ekonomitë e Ballkanit Perëndimor janë ndër më të prekurat nga ikja e trurit. Sot rreth një e pesta e popullsisë së lindur në Ballkanin Perëndimor jeton jashtë vendit. Në pesë vitet e fundit popullsia në moshë pune në Ballkanin Perëndimor u zvogëlua me më shumë se 400 000 individë", ka thënë ajo.

Bregu ka theksuar se ka flukse në rritje të emigrantëve kudo. "Ne i dimë të gjithë faktorët që po nxisin ikjen e trurit të të rinjve. Që nga papunësia e lartë, varfëria, deri te përjashtimi prej mundësive. Ne i dimë edhe faktorët tërheqës drejt Evropës. Është afërsia gjeografike, por edhe politikën pritëse për emigrantët e aftë për punë nga vendet e BP-së, në disa vende anëtare të BE-së. Por unë dua ta shtroj këtë histori nën një këndvështrim tjetër. Sa na kushton në të vërtetë kjo? A mund të vendoset një çmim për njerëzit që largohen nga rajoni? Në një farë mënyre, po, mundet. Mesatarisht, kostoja e arsimit të lartë për person varion nga mbi 18 000 euro në Shqipëri deri në 34 000 euro në Serbi. Në të njëjtën kohë, Bosnjë-Hercegovina, për shembull, shpenzon më shumë se 50 milionë euro në vit për edukimin e profesionistëve në fushën e shëndetësisë, disa prej të cilëve mund të përfundojnë duke



punuar diku tjetër. A do të vazhdojë Ballkani Perëndimor të prodhojë fuqi punëtore falas për të tjerët, apo do të krijojmë një mjedis që të rinjtë tanë të zhvillohen në vendin e tyre?", ka thënë ajo.

Bregu ka pyetur se: Çfarë mendon rinia për të gjitha këto? "Edicioni i sivjetshëm i Ballkan Barometrit pyeti të rinjtë për fushat prioritare ku ata besojnë se qeveritë duhet të kushtojnë më shumë vëmendje. Mundësitë e punësimit: u theksua se nga 47

për qind e tyre, 38 për qind përmendën arsimin dhe 26 për qind renditën sigurinë si prioritet kryesor. Barometri zbuloi, gjithashtu, se 70.6 për qind e të anketuarve të moshës 18-25 vjeç mendojnë të jetojnë dhe punojnë jashtë vendit. Nëse këto synime realizohen, Ballkani Perëndimor mund të bëhet shumë shpejt një shoqëri e plakur", është shprehur Bregu.

"Pra, çfarë mund të bëjmë?", ka pyetur ajo. "Rajoni ka nevojë për lëvizje të shpejtë, duke qëndruar

me këmbët në tokë. Disa mendojnë se krijimi i një narrative pozitive që do ta ndryshonte nocionin e ikjes së trurit si një humbje kombëtare, vlerësimi i diasporës dhe ripërdorimi i emigrimit, mund të jetë një opsion i mirë. Ne mendojmë se një mjedis i favorshëm është i domosdoshëm, pasi njerëzit duan të jenë aty ku ndihen të vlerësuar dhe ku kanë kapacitetin e plotë për të ofruar vlerë. Kur njerëzit e kanë këtë, ata qëndrojnë", ka deklaruar Bregu.



# Pushteti e lavdëron Raportin e Progresit, opozita thotë se është ndër raportet më të dobëta për Kosovën

Në Kuvendin e Kosovës të enjten është diskutuar për Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2023 nga Komisioni Evropian. Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, ka thënë para deputetëve se raporti konstaton se qeveria ka vazhduar agjendën e saj ambicioze të reformave drejt BE-së. Ndërkaq deputetët e opozitës kanë theksuar raporti i sivjetmë i KE-së është ndër raportet më të dobëta ndonjëherë për Kosovën, pasi për shumicën e sektorëve janë dhënë vërejtje dhe, sipas opozitës, qeveria Kurti po vazhdon të bëjë politikë të gabuar në raport me BE-në

**EPOKA  
ERE****Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 30 NËNTOR** - Në Kuvendin e Kosovës të enjten është diskutuar për Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2023 nga Komisioni Evropian. Pushteti e opozita në këtë seancë të Kuvendit kanë pasur akuza mes vete sa i përket këtij raporti. Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, në fjalën e tij para deputetëve të Kuvendit, ka thënë se raporti, mes të tjerash, konstaton se qeveria ka vazhduar agjendën e saj ambicioze të reformave drejt BE-së. Sipas tij, gjatë kësaj periudhe raporti dëshmon arritje të rëndësishme legjislative të kriteret politike, të zbatimi i masave e përparim në ato ekonomike, si dhe të standardet apo kapitujt e BE-së. Ai ka thënë se në agjendën e integritimit evropian, Qeveria e Kosovës është

vlerësuar për arritjet në zbatimin e ERA II dhe PKIE 2023-27. Zëvendëskryeministri veçoi edhe reformat e brendshme në sundimin e ligjit, qeverisjen e mirë, përparimin ekonomik dhe social, liberalizimin e vizave dhe përkushtimin për bashkëpunim rajonal, “të cilat konfirmojnë se jemi duke bërë hapat e duhur në rrugën drejt të ardhmes evropiane”. “Agjenda e reformave evropiane në qeverinë tonë që nga fillimi është trajtuar me shumë seriozitet. Mobilizimi që për të kapur hapin në procesin e integritimit evropian, pas stagnimit disaveçor, po jep frytet e veta. Raporti i fundit i publikuar më 8 nëntor përfshin zhvillimet nga muaji korrik i vitit të kaluar deri në muajin qershor të këtij viti, por në qoftë se ka pasur zhvillime substanciale edhe pas kësaj periudhe, ato janë përfshirë. Është raporti i parë pas aplikimit tonë për anëtarësim në BE dhe pas vendimit për liberalizim të

vizave nga 1 janari, i vitit 2024, dy fakte këto të cilat edhe përmenden në raport”, ka thënë ai.

Bislimi ka thënë se raporti e përgëzon Kosovën për politikën e saj të jashtme kur është fjala për luftën në Ukrainë dhe vendosjen e masave dhe sanksioneve ndaj Rusisë e Bjellorusisë në përputhje të plotë me ato që ka vendosur Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. “Tek Kuvendi, gjatë vitit të kaluar, janë aprovuar 110 ligje, që është numri më i madh i ligjeve të miratuara për një vit në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Aprovimi i rregullores së re të Kuvendit pritet t’i përmirësojë kushtet dhe procedurat për mbarëvajtjen edhe më të mirë të punës suaj. Kosova është vlerësuar edhe në fushën e bashkëpunimit rajonal. Qytetarët në Ballkanin Perëndimor sot nuk do të duhet të jetojnë nën frikën e një konflikti të mundshëm, por të punojnë për një të ardhme të përbashkët, e ne si qeveri kemi përgjegjësinë për ta ndërtuar këtë të ardhme”, ka thënë Bislimi.

Po ashtu, ai ka thënë se raporti njih arritjet në fushën e energjisë, si në projekte ashtu edhe në fushën e legjislacionit si miratimi i strategjisë së energjisë 2022-2031, sigurisë më të madhe në furnizim me energji dhe rritje në investime për energji të ripërtëritshme. “Raporti, po ashtu, jep edhe sugjerime dhe rekomandime për hapat e ardhshëm që institucionet e Republikës së Kosovës duhet t’i ndjekin gjatë rrugëtimit drejt

Bashkimit Evropian. Ne tashmë jemi duke marrë seriozisht këto sugjerime dhe rekomandime dhe po përkujdesemi që të përfshihen në Programin Kombëtar për Integrim Evropian si dhe në Planin e Veprimit që jemi duke hartuar për vitet 2024-2028”, ka thënë Bislimi.

Deputetja e PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, ka thënë se raporti i sivjetmë i KE-së është ndër raportet më të dobëta ndonjëherë për vendin. Sipas saj, në shumicën e sektorëve ka vërejtje dhe vlerësime të përsëritura vit pas viti, të cilat, siç tha, flasin dhe tregojnë se institucionet e Kosovës nuk i kanë trajtuar me përkushtim këto vërejtje dhe rekomandime të dala nga raporti i vjetër. “Më duhet të them se ky raport e gjen Kosovën nën sanksione. 300 milionë euro është vlera e projekteve që i ka bllokuar BE-ja për shkak të sanksioneve që rëndojnë mbi Kosovën si pasojë e kësaj qeverie”, ka thënë ajo.

Deliu-Kodra ka theksuar se në 184 cilësime në këtë raport, 176 janë me progres jo të mirë dhe vetëm tetë me progres të mirë. Më tutje, ajo përmendi edhe vlerësimin e këtij raporti në luftën ndaj korrupsionit ku, sipas saj, konstatohet se Kosova është në fazë fillestare dhe se është bërë progres i limituar, për të cilin tha se është më i ulëti që KE-ja e ka për Kosovën.

Deputetja e LDK-së, Rrezarta Krasniqi, duke folur rreth këtij raporti, ka theksuar se gjendja në vend është më e rëndë se ajo që është e pasqyruar në të. “Derisa

sot po diskutojmë për të gjeturat e këtij raporti, gjendja jonë është edhe më e rëndë se ajo që është e pasqyruar në të, për faktin se kemi masa të vëna nga ana BE-ja për Kosovën dhe, po ashtu, për faktin e raporteve tona me shtetet mike”, ka thënë Krasniqi. Ajo ka deklaruar se Kosova vazhdon të mos angazhohet për avancimin e të ardhmes së saj evropiane, pavarësisht prej raporteve, kërkesave dhe udhëzimeve të miqve tanë.

Deputeti i Kuvendit nga radhët e AAK-së, Pal Lekaj, ka thënë se tema mbi Raportin e Progresit është temë mjaft e rëndësishme, pasi ky raport është vetë plani i së ardhmes së vendit tonë, që na tregon se ku gjendemi në proces të integritimit evropian. “Është fat i keq që raporti 2023 edhe kësaj radhe e nxjerrë Kosovën dobet në shumë dimensione e në secilin sektor”, ka thënë Lekaj derisa ka numëruar në pika të shkurtra disa nga shumë të gjeturat kryesore të këtij raporti. Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës, duke mos krijuar unitet dhe bashkëpunim me opozitën, shoqërinë civile, ekspertët e njohësit ndërkombëtarë të vendit, kishte politikë të gabuar në raport me BE-në. “Duke mos zbatuar marrëveshjet, duke mos bashkëpunuar dhe dëgjuar këshillat e ndërkombëtarëve, Kosova u përballë me problemet në Jarinjë dhe Bërnjak, pastaj me krizat me zgjedhje në komunat veriore dhe në fund sanksionet ekonomike në vlerë 500 milionë euro”, ka thënë Lekaj.

# Bislimi: Tentimi për të organizuar zgjedhje serbe në Kosovë pa kërkesë nuk është në frymën e dialogut

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, ka thënë të enjten se nuk do të lejohet mbajtja e zgjedhjeve parlamentare të Serbisë në territorin e Kosovës për komunitetin serb të Kosovës muajin e ardhshëm në mungesë të një kërkesë zyrtare nga autoritetet serbe për këtë. Ai i bëri këto komente në rrjetin social "X" si përgjigje ndaj zëdhënësit të Bashkimit Evropian (BE), Peter Stano, i cili tha një ditë më parë se blloku rekomandon që serbët e Kosovës të lejohen sërish të votojnë brenda Kosovës në zgjedhjet parlamentare të Serbisë që do të mbahen më 17 dhjetor. "Nuk janë planifikuar zgjedhje këtë vit në shtetin tonë. Nëse autoritetet e shteteve të tjera preferojnë të organizojnë zgjedhje në Kosovë për diasporën e tyre, atëherë zyrtarisht duhet t'u kërkojnë autoriteteve

tona një vendim pozitiv dhe përkrahje. Tentimi për të organizuar zgjedhje pa një kërkesë paraprake apo vendim pozitiv nuk është në frymën e dialogut dhe nuk i kontribuon ndërtimit të besimit. Përdërisa nuk ka një kërkesë zyrtare direkte, atëherë nuk mund të ketë vendim. Z. Stano besoj e di këtë", ka shkruar Bislimi.

Të mërkurën Stano tha se serbët e Kosovës nuk janë lejuar nga autoritetet e Kosovës të votojnë në Kosovë për zgjedhjet parlamentare në Serbi dhe se "ky vendim nuk është në frymën e dialogut, parimit të mbrojtjes së të drejtave të pakicave dhe ndërtimit të besimit mes Kosovës dhe Serbisë".

Zgjedhjet parlamentare në Serbi mbahen më 17 dhjetor.

Më 19 nëntor, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një letër dërguar shefit të misionit në Kosovë të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Michael Davenport, kishte thënë se Kosova dhe Serbia duhet të arrijnë



një marrëveshje të posaçme në mënyrë që pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë, që kanë shtetësi të dyfishtë, të mund të votojnë në territorin e Kosovës për zgjedhjet parlamentare serbe. Sipas një praktike që daton nga viti 2017, serbët në Kosovë kanë marrë pjesë në zgjedhjet serbe dhe votat janë grumbulluar nga OSBE-ja.

Më pas ato vota janë numëruar në Rashkë dhe Vranjë, dy qytetet kufitare të Serbisë. Kjo praktikë është lejuar nga autoritetet e Kosovës deri në vitin e kaluar. Më 2022, nga partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, ishte thënë se Serbia duhet t'i bëjë kërkesë direkte Kosovës për mbajtje të këtyre zgjedhjeve në territorin e

saj.

Në prill të atij viti janë mbajtur zgjedhjet në Serbi dhe, për herë të parë, Qeveria e Kosovës nuk ka lejuar mbajtjen e zgjedhjeve në territorin e Kosovës. Si rezultat, serbët e Kosovës janë organizuar dhe me autobusë kanë udhëtuar drejt Serbisë për të votuar.

Në janar të atij viti Kuvendi i Kosovës miratoi edhe një rezolutë, përmes së cilës u kundërshtua mbajtja e votimeve në Kosovë për një referendum të Serbisë për ndryshimet kushtetuese.

Vendet e Quintit, Shtetet e Bashkuara, Britania, Gjermania, Italia dhe Franca dhe Bashkimi Evropian e patën pritur me keqardhje miratimin e rezolutës. Komuniteti ndërkombëtar i ka bërë vazhdimisht thirrje Qeverisë së Kosovës që të gjejë mënyra për mbajtjen e zgjedhjeve serbe. Zgjedhjet e fundit parlamentare, që Serbia i ka organizuar edhe për komunitetin serb në Kosovë, ishin ato të 21 qershorit të vitit 2020.

## Serbia paralajmëron hapjen e një shtabi policor në Preshevë

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Ministri i Punëve të Brendshme i Serbisë, Bratislav Gashiq, njoftoi se në ditët në vijim do të hapet një shtab policor në Preshevë, në jug të Serbisë, dhe se do të shtohen veprimet në zonën kufitare me Maqedoninë e Veriut dhe Bullgarinë.

Presheva është komunë e banuar me shumicë shqiptare dhe së bashku me Bujanocin dhe Medvegjen, ku jetojnë po ashtu shqiptarë, njihen si Lugina e Preshevës.

Gashiq ka deklaruar se policia "po bën gjithçka për ta frenuar migrimin e parregullt dhe për t'i dekurajuar dhe arrestuar të gjithë trafikuesit e njerëzve", njoftoi Ministria e Brendshme serbe më 30 nëntor. "Anëtarët e MPB-së do të



marrin të gjitha masat për ta parandaluar kalimin e parregullt të emigrantëve në vendin tonë. Ne do të qëndrojmë në këtë zonë, por edhe në veri të vendit, derisa ta zgjidhim plotësisht këtë problem",

ka thënë Gashiq në qendrën rajonale të policisë kufitare në drejtim të Bullgarisë.

Policia serbe në fund të tetorit të vitit 2023 i shtoi veprimet pas të shtënave në qytetin Horgosh në

kufi me Hungarinë, ku mbetën të vrarë tre emigrantë dhe u plagos një tjetër.

Kjo ngjarje ndodhi pas njoftimeve pothuajse të përditshme të policisë për kryerjen e kontrolleve në lokacione të ndryshme, për sekuestrim të armëve dhe municioneve dhe për "zhvendosjen" e qindra personave nga kampet jozyrtare drejt Qendrave të Pritjes të Komisarariatit të Serbisë për Refugjatët.

Raportimet për dhunë dhe konflikte të armatosura mes grupeve të trafikuesve në veri të Serbisë janë bërë më të shpeshta që nga vera e vitit 2022 dhe aktivistët kanë paralajmëruar se refugjatët janë viktimat si të kontrabandistëve, ashtu edhe të bastisjeve të policisë dhe

organizatave të ekstremit të djathtë.

Serbia ndodhet në të ashtuquajturën "Rrugën Ballkanike", e cila, pavarësisht prej rrethojave, kamerave të vëzhgimit dhe patrullave të përbashkëta kufitare, është rruga e dytë më aktive e refugjatëve, sipas raporteve të Agjencisë Evropiane të Rojeve Kufitare (Frontex).

Sipas vlerësimeve të Qendrës Joqeveritare për Ndihamen e Emigrantëve dhe Azilkërkuesve, aktualisht në Serbi janë rreth 5 000 refugjatët.

Sipas raportit të Komisarariatit Shtetëror për Refugjatët, nga shtatori në 16 kampe shtetërore janë strehuar rreth 2 300 persona, kryesisht nga Afganistani, Siria, Maroku dhe Pakistani.

## Mbahet tryezë diskutimi për raportimin profesional të gazetarëve në situata krize

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Raportimi i medieve në situata kriza dhe siguria e gazetarëve ishin në fokus të tryezës së diskutimit e cila është mbajtur të enjten në Prishtinë, organizuar nga Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës (KMSHK) dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë. Gazetarë të medieve në gjuhën shqipe dhe serbe diskutuan për sfidat gjatë raportimit, por edhe për respektimin e kodeve të etikës. Saranda Ramaj nga "Koha" foli për rrezikun nga qasja senzacionale në raportim. Ajo tha, po ashtu, se gazetarët nuk duhet të bëhen zëdhënës të institucioneve dhe

duhet të raportojnë pa emocione. Më e rëndësishmja, sipas saj, duhet të jetë vërtetësia e informacionit. Ramaj rrefeu edhe përvojën e saj të raportimit nga lufta në Ukrainë.

Genc Godanci nga televizioni T7 foli për sfidat e raportimit nga trazirat dhe kriza në veri të Kosovës. Mungesën e pajisjeve të punës dhe barrierën gjuhësore ai i përmendi si probleme me të cilat përballen gazetarët gjatë raportimit.

Maja Ficoviç nga Radio Kosovska Mitrovica, veç të tjerash, u fokusua në rëndësinë e ruajtjes së dinjitetit të



viktimave, duke mos ua publikuar identitetin e fotografitë. Sipas saj, verifikimi i fakteve para se ato të publikohen është jashtëzakonisht i

rëndësishëm në të tilla situata. Remzie Shahini-Hoxhaj, ligjëruese në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës "Hasan

Prishtina", foli për balancimin e raportimit në situata krize dhe vështirësitë që i hasin gazetarët si dhe respektimin e kodeve të etikës.

Ndërkaq Labinot Leposhitica nga zyra ligjore e BIRN Kosova përmendi nevojën që gazetarët të kenë njohuri për obligimet dhe përgjegjësitë e tyre gjatë raportimit, si dhe pajisjen e tyre me mjete mbrojtëse dhe mjete të punës kur raportojnë në situata krize. Ai i përmendi trazirat e marsit të vitit 2004 si rast në të cilin mediet kanë ndikuar negativisht, duke mos raportuar me kujdes dhe në mënyrë profesionale.

## PSD-ja kërkon lirim të aktivistëve, ofron dëshmi për dhunën dhe armët e përdorura nga policia

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Partia Socialdemokrate (PSD) ka mbajtur konferencë për medie të enjten, në të cilën ka kërkuar lirim të kryetarit Dardan Molliqaj dhe të pesë aktivistëve të kësaj partie. Ata janë arrestuar të mërkurën gjatë protestës së PSD-së në kundërshtim të vizitës së

kryetares së Dhomave të Specializuara të Gjykatës Speciale, Ekaterina Trendafilova. Anëtar i kryesisë së PSD-së, Dren Kukaj, ka paraqitur me fotografi, siç ka thënë, dhunën e përdorur nga Policia e Kosovës gjatë protestës. Sipas tij, në arrestimin e aktivistëve,

përveç policëve, është përfshirë edhe një person i sigurimit privat të hotelit ku ka qëndruar Trendafilova. Kukaj tha se nuk janë përdorur armë nga aktivistët, por nga Policia e Kosovës. Ai kërkoj nga prokuroria dhe policia të merren për bazë faktet dhe të zbardhet e vërteta.



## Kërkohet sërish shtyrja e afatit për reregjistrimin e makinave në veri

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Drejtoria e Policisë së Kosovës për rajonin e Veriut ka kërkuar sërish nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës që ta shtyjë edhe për 15 ditë afatin për reregjistrimin e makinave me targa serbe në ato RKS - Republika e Kosovës. Zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë", sqaroi se një kërkesë e tillë është dërguar tek autoritetet qendrore për shkak se janë vërejtur radhë të gjata para qendrave për reregjistrim. "Ka disa vetura me probleme teknike. Nëse makinat kanë probleme teknike, qytetarët nuk mund ta marrin konfirmimin brenda ditës që vetura punon dhe nuk mund ta marrin sigurimin. Ne kemi vërejtur një problem teknik dhe

për këtë kemi kërkuar nga Ministria [e Brendshme] që të shtyhet afati, por kjo nuk do të thotë se do të ndodhë kështu", tha ai. Që nga 1 nëntori 2023 qytetarëve të katër komunave veriore me shumicë serbe, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan e Zubin Potok, u është dhënë afati i fundit, njëmuajor, për reregjistrim të automjeteve të tyre nga targat KM (Mitrovica e Kosovës) në RKS. Targat KM, dhe me akronime të tjera serbe për qytetet e Kosovës, janë lëshuar nga autoritetet serbe dhe konsiderohen të paligjshme nga autoritetet në Kosovë. Megjithatë, qarkullimi i makinave me targa të tilla është toleruar deri më tani në veri, ndërsa në zonat e banuara nga serbët në jug të Ibrit, ato ishin larguar nga përdorimi më shumë



se dhjetë vjet më parë. Sipas përlogaritjeve të sektorit civil serb, në komunat në veri të

Kosovës, të banuara me shumicë serbe, ka pasur rreth 10 000 vetura me targa KM. Ndërkaq,

sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, muajin e fundit janë reregjistruar në targa RKS afër 4 000 makina. Elshani tha se nëse MPB-ja nuk miraton kërkesën për zgjatjen e afatit për reregjistrim, Policia e Kosovës nga 1 dhjetori nuk do ta lejojë lëvizjen e makinave me targa KM. "Do të ndalen nga policia e rregullt ljo nga njësitë speciale të policisë që janë në veri të Kosovës]. Do të merren targat, do t'i shqiptohet gjoba prej 150 eurosh. Nëse qytetarët vozisin pa targa, makinat e tyre do të sekuestrohen", tha Elshani. Çështja e targave KM është aktualizuar që nga viti i kaluar dhe ka shkaktuar një sërë krizash në veri të Kosovës, daljen e serbëve nga institucionet e Kosovës, protesta e vendosje të barrikadave.

## BE-ja dhe UNDP-ja mbështetin organizatat e shoqërisë civile për promovimin e iniciativave për drejtësi tranzicionale

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Në përpjekje të përbashkët për ta rritur përgjegjësinë mbi krimet e luftës, për ta promovuar drejtësinë tranzicionale, për ta inkurajuar dialogun ndëretnik si dhe për t'i fuqizuar të mbijetuarit/at e dhunës seksuale të ndërlidhura me konfliktin në Kosovë, projekti rajonal i financuar nga BE-ja dhe i zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), ka nënshkruar marrëveshje me nëntë Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC) për ta mbështetur punën e tyre për adresimin e sfidave me të cilat përballet shoqëria e Kosovës pas konfliktit si dhe për avancimin e kauzës për paqe dhe pajtim. Nëntë OSHC u përzgjedhën



përmes thirrjes të parë dhe të dytë për projektpropozime, duke

përfshirë Kosovo 2.0, Instituti i Kosovës për Drejtësi, Qendra për

Zgjidhje Alternative të Kontesteve, Fondacioni Jahjaga, Instituti për Studime Politike në Prishtinë, OJQ Avoko, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarave të Torturës, Medica Gjakova dhe Demokraci Plus. Marrëveshjet u nënshkruan në prani të Nuno Queiros, përfaqësues i përhershëm i UNDP-së dhe Jarmo Feliks Hellepikangas, shef i Seksionit për Sundimin e Ligjit dhe të Drejtat e Njeriut në Zyrën e BE-së në Kosovë. Me këtë rast, Queiros ka theksuar se kjo ngjarje është pasqyrim i përkushtimit të përbashkët për të inkurajuar partneritet në dhënie dhe kontributit të mëtejshëm në procesin e drejtësisë tranzicionale

në Kosovë dhe për ta njohur përkushtimin dhe përpjekjet e partnerëve të shoqërisë civile për formësimin e një të ardhme më të qëndrueshme dhe në harmoni për Kosovën. Nga ana tjetër, Jarmo Hellepikangas ka pohuar se BE-ja ka mbështetur iniciativat në drejtësi tranzicionale si në nivel rajonal, po ashtu edhe në nivel lokal të cilat synojnë forcimin e llogaridhënies mbi krimet e luftës të kryera gjatë viteve 1990 si dhe promovimin e pajtimit në rajon. "Ne mbetemi të përkushtuar për vazhdimin e mbështetjes sonë dhe do të donim të shohim më shumë iniciativat lokale mbi këto çështje", ka deklaruar Hellepikangas.

## Nga 1 janari deri në muajin nëntor janë kryer 623 operacione neurokirurgjike

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Në Klinikën e Neurokirurgjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) nga 1 janari deri në muajin nëntor janë kryer 623 operacione të ndryshme të natyrës neurokirurgjike, në bashkëpunim me anesteziologët e Klinikës së

Anesteziologjisë, kurse në total kanë qenë të shtrirë 820 pacientë. Mjekët neurokirurgjicë kanë kryer edhe mbi 3 000 vizita ambulatorore. Aktualisht, me investim nga Ministria e Shëndetësisë e në bashkëpunim me ShSKUK po zbatohet

projekti për rinovim të sallave operative. Krahas kësaj, klinika është furnizuar me aparatura bashkëkohore si Mikroskop Operativ Neurokirurgjik me dritë Fluorescente, Aspirues Ultrasonik, Ultratingullin Operator, Neuronavigacion, Endoskop Cranial.



# Përse Kosova nuk është pjesë e OSBE-së?

**PRISHTINË, 30 NËNTOR** - Për t'u bërë shtet anëtar i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) nevojitet pajtimi i të gjitha shteteve pjesëmarrëse.

Organizata më e madhe rajonale e sigurisë në botë numëron aktualisht 57 vende anëtare, që shtrihen në tri kontinente: Evropë, Amerikë e Veriut dhe Azi. Në mesin e tyre janë edhe shtetet e Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia e Veriut, por jo edhe Kosova.

Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës - e shpallur në vitin 2008 - dhe kundërshton pjesëmarrjen e saj në organizata rajonale dhe ndërkombëtare. Për më tepër, ajo ka edhe mbështetjen e Rusisë, e cila, po ashtu, është anëtare e OSBE-së.

Në radhët e kësaj organizate janë edhe Greqia, Qiproja, Rumania, Sllovakia dhe Spanja - pesë vendet e Bashkimit Evropian që nuk e njohin Kosovën - ashtu si edhe shtete të tjera mosnjohëse.

"Radio Evropa e Lirë" pyeti Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë se a planifikon të aplikojë për anëtarësim në OSBE dhe ku e sheh pengesën kryesore në këtë proces, por nuk mori përgjigje.

Ngjashëm, as misioni i OSBE-së në Kosovë nuk iu përgjigj kërkesës së REL-it për koment në lidhje me këtë temë, ndonëse konfirmoi marrjen e pyetjeve.

## Çfarë bën OSBE-ja në Kosovë?

Këshilli i Përhershëm i OSBE-së mori vendim për themelimin e Misionit të OSBE-së në Kosovë në korrik të vitit 1999 - pak javë pas përfundimit të luftës në Kosovë. Misionit iu dha rol udhëheqës në çështjet që lidheshin me ndërtimin e institucioneve, demokracinë dhe të drejtat e njeriut.

Ai është misioni më i madh në terren i OSBE-së, ndërsa mandati i tij është i përcaktuar në Rezolutën



1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, si dhe në vendimin numër 305 të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së.

Misioni, aktualisht, ka pesë qendra rajonale - në Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan.

Në uebfaqen e tij thuhet se ai është veçanërisht i angazhuar për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare, monitorimin e gjyqësorit, lirinë dhe zhvillimin e medias, promovimin e mekanizmave kundër diskriminimit, përmirësimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën politike dhe publike e të tjera.

Misioni i OSBE-së, po ashtu, bashkëpunon dhe mbështet Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, me qëllim të, siç thuhet, forcimit të kapaciteteve të tyre, në përputhje me standardet dhe praktikatat e mira ndërkombëtare.

Misioni mbështet edhe zbatimin e

marrëveshjeve që dalin nga bisedimet midis Kosovës dhe Serbisë të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Aktualisht në krye të tij është ambasadori Michael Davenport, diplomat britanik i karrierës.

## Kosova nuk merr pjesë në samitin në Shkup

Duke mos qenë anëtare e OSBE-së, Kosova nuk merr pjesë në takimin ministror të kësaj organizate që zhvillon punimet sot dhe nesër në Shkup të Maqedonisë së Veriut - vendit që aktualisht kryeson OSBE-në.

Samiti mbledh 76 delegacione nga 57 vende anëtare të OSBE-së dhe shtete partnere. Në mesin e të pranishmëve është edhe sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken. Por, vëmendjen e medieve e mori prania e ministrit të Jashtëm rus, Sergey Lavrov.

Edhe pse i sanksionuar nga Perëndimi, për shkak të luftës së

Rusisë në Ukrainë, Maqedonia e Veriut e lejoi pjesëmarrjen e tij në samit.

Për rrjedhojë, ministri i Jashtëm i Ukrainës, Dmytro Kuleba, njoftoi se nuk do të jetë i pranishëm.

Vitin e kaluar Kosova ka aplikuar për anëtarësim në Këshillin Evropës dhe në Bashkimin Evropian.

Në gati 16 vjet pavarësi, vendi ka arritur të anëtarësohet në disa organizata ndërkombëtare - në mesin e tyre: Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Komiteti Olimpik, Federata Evropiane e Futbollit dhe Federata Botërore e Futbollit.

Kosova nuk është ende as anëtare e Kombeve të Bashkuara, Organizatës Botërore të Tregtisë, Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL) e të tjera.

Pavarësia e Kosovës njihet nga 117 shtete.

Serbia, në disa raste, ka zhvilluar fushatë kundër njohjes apo për çnjohje të Kosovës, përkundër faktit se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka konstatuar në vitin 2010 se pavarësia e Kosovës "nuk bie ndesh me ligjin ndërkombëtar".

## Çfarë është OSBE-ja?

OSBE-ja, institucioni më i madh në botë i sigurisë ndërkombëtare, u themelua gjatë Luftës së Ftohtë si platformë për dialog mes shteteve perëndimore dhe shteteve të Bllokut Lindor. Me seli në Vjenë, Austri, kryeqytetin e një prej shteteve të pakta në Evropë që nuk është pjesë e NATO-s, OSBE-ja përbëhet nga 57 shtete anëtare, përfshirë Rusinë, Shtetet e Bashkuara, Kanadanë dhe pothuajse të gjitha shtetet në Evropë. Misioni i organizatës, i deklaruar që nga themelimi i saj më 1975, është "për të

punuar për stabilitet, paqe dhe demokraci për më shumë se 1 miliard persona, përmes dialogut politik lidhur me vlerat e përbashkëta dhe përmes punës praktike që synon të bëjë një ndryshim të qëndrueshëm".

Organizata, po ashtu, ka një trup parlamentar prej 323 anëtarësh - Asambleja Parlamentare e OSBE-së detyra kryesore e të cilit, siç thuhet, është "të ndërmjetësojë dialogun ndërparlamentar për të avancuar qëllimet e OSBE-së për siguri gjithëpërfshirëse".

# Vritet në Prishtinë gruaja e këshilltarit të Pacollit, Liridona Murseli

**PRISHTINË, 30 NËNTOR** - Policia e Kosovës ka njoftuar të mërkurën vonë se një grua është gjetur e vrarë në një veturë në Prishtinë.

Viktima është Liridona Murseli, gruaja e Naim Murselit, këshilltarit të presidentit të AKR-së, deputetit të Kuvendit të Kosovës, Behgjet Pacolli.

Policia e pranoi një thirrje për të shtëna me armë në rrugën "Dalip Alshiqi" në kryeqytet të mërkurën rreth orës 20:20, ka pohuar zëdhënësja për rajonin e Prishtinës e Policisë së Kosovës, Flora Ahmeti. "Policia si dhe mjekët emergjentë, menjëherë kanë dalë në vendin e ngjarjes, ku në një veturë kanë hasë një person pa shenja jete. Vdekjen e viktimës (femër) e ka konstatuar ekipi mjekësor në vendin e ngjarjes", ka thënë Ahmeti, duke shtuar se,


sipas të dhënave fillestare, besohet se ajo është vrarë me armë zjarri.

Policia në bashkëpunim me Prokurorinë i ka nisur hetimet rreth kësaj vrasjeje.

Rrethanat e vrasjes janë ende të panjohura.

Mediumi suedez "Expressen", teksa ka raportuar për këtë rast tragjik, ka njoftuar se viktima ishte shtetase e Suedisë.

Lidhur me ngjarjen tragjike ka reaguar edhe deputeti suedez Magnus Jacobsson, i cili e ka quajtur këtë ngjarje të tmerrshme. Siç ka raportuar "Expressen", Jacobsson e njihje personalisht viktimën dhe bashkëshortin e saj. "Ajo ishte një person absolutisht fantastik. Njeri i ngrohtë, i mirë. Ju nuk e kuptoni vërtet se mund të ndodhë", ka thënë ai për mediumin suedez.



# Kurti: Industria e drurit, sektor strategjik për zhvillimin ekonomik të Kosovës

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në Konventën e 6-të të Industrisë së Drurit. Duke e konsideruar këtë si njërin nga sektorët strategjik për zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës, kryeministri tha se ajo ka potencial për t'i rritur përfitimet e brendshme nga përdorimi i burimeve vendore, duke kontribuar edhe në thellimin e lidhjeve me nënsektorët e tjerë si, për shembull, tekstilin, produktet metalike dhe shërbimet që lidhen me industrinë në përgjithësi. Para të pranishmëve ai tha se ndihet i lumtur që sot po flasim pikërisht për këtë sektor që krijon vende pune dhe është një shtytës i zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor. "Kjo industri në zhvillim të vazhdueshëm, jo vetëm në tregun e brendshëm, por edhe në atë të jashtëm, ka kontribuar me rritje të eksporteve për përmirësimin e bilancit tregtar të vendit tonë", ka thënë Kurti, duke shtuar se eksportet totale për dyer, dritare,

mobilieri të drurit dhe ndërtesat e parafabrikuara, në dy vitet e fundit, 2021 e 2022 dhe dhjetë muajt e vitit 2023, janë me vlerë 563 milionë euro. Ai ka thënë se deri në fund të muajit dhjetor 2023 presin të janë rreth 600 milionë euro. Eksporti i mallrave, siç tha kryeministri, ka arritur për herë të parë vlerën prej 920 milionë eurove në vitin që shkoi, pra më 2022, dyfish më shumë se dy vjet më parë. Ndërsa, sipas tij, rekordi i eksportit të shërbimeve ka arritur vlerën prej mbi 2.5 miliardë eurosh në vitin 2022. "Shifër kjo që paraqet 32 për qind rritje nga viti 2021 dhe 153 për qind rritje nga viti 2020, që vetëm pjesërisht shpjegohet me vitin e pandemisë pa vaksina", ka thënë ai. Kurti ka theksuar se si rezultat raporti eksport-import është ngushtuar nga gati 1 me 9 sa ishte në vitin 2019, në më pak se 1 me 6 sa është aktualisht. "Investimet e huaja, po ashtu, janë dyfishuar. Për herë të parë ato kanë arritur vlerën



rekorde prej 772.3 milionë eurosh në vitin 2022, ose 84 për qind rritje krahasuar me vitin 2021, kurse 101 për qind rritje nga viti 2020 e 138 për qind rritje nga viti 2019 si vit para pandemik", është shprehur ai.

Më tej, kryeministri Kurti ka thënë se përpunimi i drurit dhe i mobilieve sipas analizave të performancës së industrisë në vendin tonë, në kuadër të politikës industriale, vlerësohet si

nënsektor "Yll në rritje", kontribuon në 12 për qind bilancin tregtar, duke qenë ndër të rrallët nënsektorë që kanë kontribut pozitiv në uljen e deficitit tregtar.

## AKP-ja rimerr disa asete në Mal të Zi

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) tha se ka arritur të kthejë tetë asete në Mal të Zi të një ndërmarrjeje nga Kosova. Sipas një njoftimi, AKP-ja tha se fitoi rastin gjyqësor, në shkallë të dytë, për asetet në Mal të Zi të KBI Kosova Export - Industria e Mishit nga Fushë Kosova. Në fillim të këtij viti AKP-ja kishte thënë se e kishte kuptuar që tetë asete të kësaj ndërmarrjeje ishin shitur nga Agjencia për Likuidimin e Personave Juridike Privatë të Serbisë dhe ishin regjistruar në emër të personave fizikë në Drejtorinë për Kadastër në kryeqytetin e Malit të Zi, Podgoricë. "Më 29 nëntor 2023 AKP-ja ka pranuar aktvendimin e shkallës së dytë administrative



në Podgoricë, me të cilin është aprovuar ankesa e AKP-së, duke anuluar aktvendimin e Drejtorisë për Kadastër në Podgoricë, me të cilin këto asete ishin regjistruar në emër të

personave fizikë në Podgoricë, pasi që ishin shitur nga Agjencia për Likuidimin e Personave Juridike Privatë të Republikës së Serbisë në mënyrë të paligjshme", u tha në njoftim.

Pronat e KBI Kosova Export - Industria e Mishit ndodhen në Podgoricë, Tivar dhe Budvë. Më herët gjatë nëntorit, AKP-ja i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se pas vitit 1999 pronat e kësaj ndërmarrjeje ishin përvetësuar ilegalisht nga kompania "Klanica" në Krlevë, e më pas ishin shitur. KBI Kosova Export - Industria e Mishit ka gati 1 000 metra katrorë hapësira biznesi në lokacione prestigjioze në Mal të Zi. Në qendër të Podgoricës janë shtatë të tilla me një sipërfaqe totale prej 700 metrash katrorë - prej të cilave 500 janë në katet përdhës të objekteve të banimit dhe 200 në bodrumet e tyre. Në qendër të Budvës është një hapësirë prej 60 metrash katrorë,

ndërsa në Tivar prej 137 metrash katrorë, plus 47 metra katrorë bodrum. Përveç pronave të kësaj ndërmarrjeje, sipas autoriteteve në Kosovë, shteti ka mbi 160 prona në shtetet fqinje - përfshirë në Serbi, Mal të Zi, Bosnjë-Hercegovinë, Maqedoni të Veriut, Kroaci dhe Slloveni - të cilat ishin formuar pas shpërbërjes së Jugosllavisë. Shumica e këtyre pronave janë në Serbi dhe AKP-ja ka kërkuar nga shtetet fqinje që ta ndalojnë ndryshimin e pronësive të këtyre pronave dhe ka thënë se ato janë përvetësuar paligjshëm. APK-ja menaxhon të gjitha ish-ndërmarrjet shoqërore të Kosovës dhe pretendon se është pronarja e vetme e atyre pronave.

## KEDS-i zë më shumë se 600 persona duke vjedhur rrymë gjatë muajit nëntor

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Zvogëlimi i humbjeve në rrjet, krahas investimeve, vazhdon të mbetet prioriteti i KEDS-it. "Aksionet për kontrolle të keqpërdoruesit e dyshimtë të energjisë elektrike vetëm sa po shtohen tashmë kur jemi futur në sezonin e dimrit", ka njoftuar KEDS-i. Sipas këtij njoftimi, ekipet e kontrollit të KEDS-it të shpërndarë gjithandej Kosovës vetëm gjatë muajit nëntor kanë realizuar afër 8 500 kontrolle, prej të cilave më shumë se 600 sosh janë zënë në vepër duke e vjedhur energjinë elektrike. "Të gjithë këtyre konsumatorëve, me t'u zënë, u faturohet rikthimi i humbjeve i barasvlershëm me faturën 6 mujore, nëse janë konsumatorë të amvisërisë,

dhe me faturën njëvjeçare nëse janë biznese, pra konsumatorë komercialë. Pos kësaj, keqpërdorimi i energjisë elektrike hyn në kuadër të 'Vjedhjes së shërbimeve', e cila, sipas nenit 314 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës është e dënueshme deri në tri vjet burg. Se KEDS-i e ka përnjëmend në luftimin e kësaj dukurie deri tek identifikimi i rastit të fundit, tregojnë faktet në terren. Shifrat flasin vetë! Për 11 muajt e parë të këtij viti, përkatësisht në periudhën janar-nëntor janë realizuar rreth 80 mijë kontrolle, prej të cilave janë identifikuar 6 mijë raste të keqpërdorimeve", ka njoftuar KEDS-i, duke theksuar se të njëjtën kohë, me qëllime të vetëdijesimit të publikut,

KEDS-i kohën e fundit ka ndërmarrë një fushatë informimi për opinionin publik lidhur me pasojat që mund të ketë kushdo që keqpërdor energjinë elektrike. "Fushata 'Rryma t'kushton ma lirë' do të thotë përdorim legal i energjisë elektrike dhe, sado që një konsumator shpenzon në muaj, atij i del më lirë sesa nëse e konsumon atë ilegalisht, pra më lirë sesa pagesa që duhet të bëjë në formë të rikthimit të humbjeve të shkaktuara ndaj kompanisë, më lirë sesa dënimi me gjobë dhe me burg nga gjykata dhe më lirë se sa rrezikimi i sigurisë personale dhe i ambientit përreth që vjen nga vandalizmi i infrastrukturës elektroenergjetike", ka njoftuar KEDS.





# Napoleon Bonaparti: Oficeri që u bë gjeneral. Gjenerali që u bë mbret dhe ndryshoi Evropën

Nga oficer artilerie në gjeneral, më pas mbret dhe në fund perandor. Napoleon Bonaparti ishte gjithçka: gjeni ushtarak, politikan, jurist, talent krijues me një dinamizëm të pasohq. Ai i dha emrin e tij ambicies dhe e bëri atë në një kohë minimale. Në ato pak vite që ndajnë Austerlitz-in nga Eaterloo, ai pushtoi botën. Kur, i mundur, e riktheu, gjurmët e tij e kishin mbetur përgjithmonë. Pastaj nga mërgimi i Shën Helenës fluturoi e u bë legjendë.

Gjithçka kishte nisur në një tjetër ishull, Korsikë, ku gjenerali i ardhshëm lindi më 15 gusht 1769 në Ajaccio, në një familje me origjinë të lashtë dhe fisnike toskane: babai i tij Giuseppe Maria Buonaparte, avokat, nëna e tij Maria Letizia Ramolino, pasardhëse e një pasaniku. Në moshën dhjetë vjeçare, një bursë i hapi dyert e shkollës ekskluzive ushtarake të Brienne-le-Château, në Francën veriore, ku fëmijët e rritur mësonin artin e luftës. Do të ishin pesë vite studim dhe lexim, si dhe vënie në lojë: shokëve nuk u pëlqente origjina e tij korsikane dhe frëngjishtja e çalë.

Napoleoni doli prej asaj shkolle me një prirej drejt vetmisë dhe një shpirt të fortë revanshi, me krenarinë të përforcuar nga një pakënaqësi e fortë antifranceze. Karriera e tij ushtarake eci shpejt: në vitin 1784 ai shkollon në Shkollën Mbretërore të Parisit dhe në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç caktohet në një regiment artilerie të vendosur në La Fère, në Picardy. Kur shpërtheu revolucionin në vitin 1789, Napoleoni u rikthye në Korsikë, duke shpresuar se nga trazirat mund të përfitonte kauza e ishullit. Por iu desh të largohej në vitin 1793 me gjithë familjen, e tij pasi u nda nga fronti independentist.

Në Paris revolucionin ia kishte lënë vendin Terrorit, gjatina po punonte me kapacitet të plotë. I emëruar kapiten, ai u dërgua nga Komiteti i Sigurisë Publike për të shtypur disidencën në Marsejë, më vonë mori komandën e trupave në Toulon, ku ishin vendosur mbretërorët, të mbështetur nga anglezët. Oficeri i ri zgjidhi shkëlqyeshëm rrethimin e qytetit, duke shfaqur një menaxhim të forcave të artilerisë që e bëri të spikasë si strateg brilant. Një sukses që i dha emërimin gjeneral brigade. Dy vjet më vonë, më 5 tetor 1795, emërohet komandant në Paris: Napoleoni shpëtoi Konventën Kombëtare duke shtypur me gjak revoltën e monarkistëve. Pas kësaj do të vinte emërimi gjeneral i Korpusit të Ushtrisë së Brendshme: vetëm 26 vjeç dhe ishte një yll në ngjitje të shpejtë.

## JOZEFINA DHE TRIUMFET NË ITALI

Në kryeqytet, djaloshi korsikan takohet me botën e madhe: shkon në teatër, organizon darka dhe vendos këmbë në sallonet me peshë. Mbetet i magjepsur nga sharmi i Jozefina Tasher, një e ve e Beauharnais, zonjë e madhe me një mijë lidhje, më e madhe se ai, e zhytur borxhe, por gjithsesi pronare e



një pasurie: ajo vë bast për atë ushtar me shikimin magnetik, ai për atë grua të rafinuar.

Më 9 mars 1796 ai u martua me të dhe më 27 të po të njëjtë muaj, ajo ishte tashmë në Nice në komandën e ushtrisë italiane, gati për të luftuar me Austrinë, udhëheqëse e koalicionit të monarkive të mëdha evropiane, të terrorizuara nga spektri i "murtajës revolucionare". Fushata fillon më 12 Prill; Më 14 maj Napoleoni hyri në Milano si triumfues. Në pak më shumë se një muaj, i shndërruar në legjendë, ushtari i ri i befasoi të gjithë duke sulmuar nga Liguria, ndau frontin e armikut dhe shkatërroi fillimisht piemontezët dhe më pas austriakët e gjeneralit të vjetër Beaulieu, i cili mbeti në mëshirën e zgjedhjeve strategjike të rivalit të tij.

Në krye të një ushtrie të dobësuar, të paguar keq, të pajisur dobët, inferiore, Napoleoni realizoi kryeveprën e tij të parë, të ndërtaur mbi menaxhimin inovativ të trupave, përgatitjen e përpiktë të betejave, zgjedhjen e oficerëve po aq të guximshëm sa ai, aftësinë për të rigjallëruar ushtrinë duke u dhënë burrave një ndjenjë përkatësie, që bëhet një ëndërr e përbashkët e lavdisë kur marrëdhënia midis trupës dhe udhëheqësit konsolidohet deri në atë pikë, sa të bëhet përkushtim fanatik ndaj liderit.

Prandaj Napoleoni në Itali zbulon se ai ka një madhësi, po aq të madhe sa ambicia e tij. Dhe ai fillon t'i shërbejë të dyjave. Më 5 gusht në Castiglione delle Stiviere fitoi betejën e tij të parë të madhe, duke shtyrë deri në Venecia dhe duke e detyruar Austrinë të firmosë Traktatin e Campo Formio. I rrethuar nga dafina e triumfuesit, në Francë ai bëhet politikisht me shumë peshë. Prandaj e largojnë nga Parisi, duke i besuar pushtimin e Egjiptit, duke iu kundërvënë interesave ekonomike të anglezëve në dete. Fushata do të ishte një dështim: pavarësisht betejës së fituar të Piramidave në 21 korrik 1798, luftëtarit iu desh të shohë shkatërrimin e plotë të flotës përballë admiralit anglez Horatio Nelson, si dhe të dorëzohej përballë pamundësisë për të marrë fortesën e lashtë të San Giovanni d'Acri.

Me t'u rikthyer në atdhe, gjen në Paris krizë dhe ushtrinë copë-copë. I mbetej vetëm grushti i shtetit. Në 9 nëntor 1799, Bonaparti shpërmdan Dhomat, pushteti i kalon tre konsujve që hartojnë një kushtetutë të re, e cila më pas do të ratiifikohej me plebishit. I emëruar Konsull i

strategjike e Bonapartit: 13 dhjetor 1805, në përvjetorin e kurorëzimit të tij, ai shkatërroi austro-rusët. Një vit më pas mundi Prusinë në Jena dhe hyri triumfalisht në Berlin. Në vitin 1807, ushtria e Car Aleksandrit kapitulloi në Friedland. Praktikisht i pamposhtur, në krye të një ushtrie të dehur nga sukcesi, perandori vendos një bllokadë kontinentale, duke ndaluar anijet që mbajnë flamurin anglez të ankorohen në çdo port, duke shpresuar kështu të goditet ekonomia britanike.

Papës që refuzon t'i bashkohet, ai i përgjigjet me marrjen e Romës dhe aneksimin e Shtetit Papnor në Perandori, dhe kur i vjen njoftimi i shkishërimit, ai arreston papën dhe e transferon në Francë, fillimisht në Grenoble dhe më pas në Fontainebleau.

Bllokada, megjithatë, ishte një dështim. Shumë shtete e anashkaluan, duke përfshirë Portugalinë, e cila pushtohet në shenjë hakmarjeje.

Më pas, Napoleoni përfitoi nga mosmarrëveshja dinastike midis Karlit VI dhe djalit të tij për t'i detyruar të dy të abdikojnë dhe të vendosin vëllanë e tyre Jozefin në fronin e Spanjës, por pa qenë në gjendje të zbutte luftën guerile apo të shkatërronte forcën e ekspeditës angleze. E cila kishte çliruar ndërkohë shtetin luzitanian. Megjithë vështirësitë, në vitin 1809 u gjuhëzua edhe koalicioni i pestë (një tjetër aleancë midis Perandorisë Austriake dhe Mbretërisë së Bashkuar), fitore që erdhi prej epërsisë së padiskutueshme ushtarake.

Ai pushton Vjenën dhe Kalanë e Schönbrunnit dhe u diktoi austriakëve një paqe shumë të ashpër. Ndërkohë arrin një marrëveshje me kryeministrin e tyre Metternich për një martesë shtetërore të aftë për të pajtuar përfundimisht Francën dhe Austrinë dhe, me shpresë, t'i jepte perandorit trashëgimtarin e shumë dëshiruar. Ai ishte divorcuar nga Jozefina, shoqja që adhuronte, por e cila ishte jobesnike, dhe tani ishte martuar me Mari Luizën e Austrisë, mbesa e Marie Antuanetës.

Por djali i tij i lindur në 1811, Napoleon Françesku, i njohur si Mbreti i Romës, nuk do të ngitej kurrë në fron dhe do të vdiste në moshën 21-vjeçare.

I vendosur për t'i dhënë një goditje përfundimtare edhe carit Aleksandër, perandori përpigjet të

pushtojë Rusinë, një sipërmarrje titanike që do të përmbylej me një humbje epokale. Shifrat nuk gënjëjnë: perandori nisat në krye të një ushtrie prej 700 mijë burrash, nga të cilët 400 mijë nuk do të ktheheshin kurrë. Disfata e tij bën që fuqitë evropiane të ngrejnë kokë.

Me t'u rikthyer në Francë, Napoleoni punon natë e ditë për të ringritur në këmbë ushtrinë, afro 400 mijë, në pjesën më të madhe rekrutë të rinj. Luanit të plagosur i mjaftojnë për të mbajtur larg prusianët, por joa koalicionin e madh, duke përfshirë dhe austriakët, të cilët duket se nuk e marrin parasysh martesën e një viti më parë.

Ushtria franceze kapitullon në Lajpc. Napoleoni ia beson perandorinë të shqoes dhe kryeqytetin vëllait, vihet në krye të 60 mijë veteranëve dhe për dy muaj frenon forcat armike. Por më pas, iu duhet të lëshojë përballë prusianëve. Në 31 mars 1813, car Aleksandri hyn në Paris. Napoleoni detyrohet të abdikojë. Pas një tentative vetëvrasjeje me arsenik, që shmanget për mrekulli, si dhe një lamtumirë shumë emocionuese që i bën Gardës së Vjetër, shkon në Marsejë e prej aty nisat për në ekzilin e tij, në Elbë. Në ishull e shfryn hiperaktivizmin që e karakterizon duke ndërtaur rrugë dhe infrastrukturë, si dhe mban një sy vigjilent nga Parisi ku Luigji XVIII, që u rikthye në fron pas abdikimit të Napoleonit, e ka humbur tashmë mbështetjen e popullit.

## ARRATIA NGA ELBA DHE 100 DITËT LEGJENDARE

Dhjetë muaj izolim mund të mjaftojnë. Arratiset edhe përballë syrit vigjilent të anglezëve dhe në 1 mars 1815 zbarkon në Antibes: fillojnë kështu 100 ditët legjendare. Në marshimin drejt Parisit shkakton një entuziasëm popullor që nuk e priste: për të bindur trupat që dërgonte mbreti që të ulnin armët, mjaftonte që të shfaqej vetë para tyre. I hipur sërish në fron, riorganizon ushtrinë dhe harton një kushtetutë më liberale.

E pret dueli final. Përballë ka armiq të përhershëm, në krye Mbretërinë e Bashkuar dhe Prusinë. Planifikon sërish që të përçajë forcat kundërshtare, por kjo manovër i realizohet vetëm pjesërisht. Vaterloja do të ishte kapitulli i fundit e historisë ushtarake të papërsëritshme. Gabime taktike dhe në organizim sjellin disfatën historike të 18 qershorit 1815, mbi të cilën rëndon edhe zgjedhja e gjeneralëve që nuk ishin në lartësinë e detyrës.

Pasi gjen strehim në kështjellën Malmaison, Napoleoni pret fatin e tij: në 15 korrik u dorëzohet anglezëve. Eshhtë i bindur se mund të jetojë si qytetar i thjeshtë në Angli apo SHBA, por e pret ekzilin në ishullin e Shën Helenës, në oqeanin Atlantik. Në atë copëz toke, që kontrollohet me sy prej kontinentit anglez, njeriu që kish qenë zot i Evropës vdes në 5 maj 1821, nga një tumor në stomak. I varosur në ishull, trupi i tij do të rikthehej në Paris për një funeral solemn vetëm në vitin 1840. / bota.al

## PERANDORI FRANCEZ DHE MBRETI I ITALISË

Në kulmin e lavdisë dhe pushtetit, ai vë në shenjëstër Anglinë. Por pushtimi i planifikuar i ishullit përplasat me disproporcionin e forcave detare dhe fundoset pas asgjësimit të flotës në Trafalgar, përsëri nga Nelsoni. Më 1805, Napoleoni përballet me koalicionin e tretë antifrancez, i cili këtë herë përfshinte Anglinë, Austrinë dhe Rusinë, duke dërguar marshallin e tij më të aftë, Andrea Massena, për të "shqetësuar" austriakët në Itali, teksa ai personalisht mori komandën e "Ushtrisë së Madhe". Eshhtë pragu i Austerlitz-it, kryevepra



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Kosova shënon ngritje rekorde në renditjen e FIFA-s, Shqipëria bie për tri pozita

**PRISHTINË, 30 NËNTOR** - Përfaqësuesja e Kosovës ka shënuar ngritje rekord në ranglistën e FIFA-s, ndërsa ajo e Shqipërisë ka pasur rënie pas rezultateve jo të mira në muajin nëntor. “Dardanët” janë ngritur për plot katër pozita dhe tani janë më lart në renditje se kurrë më parë. Kosova ka kaluar nga vendi i 105-të në pozitën e 101-të, duke pasur 1202.77 pikë pas

fitores ndaj Izraelit, barazimit me Zvicrën dhe humbjes nga Bjellorusia. Ndërsa Kombëtarja e Shqipërisë ka pësuar rënie në renditjen e re të FIFA-s, pas rezultateve jo të mira në muajin nëntor. Pas barazimeve me Moldavinë dhe Ishujt Farore, Shqipëria ka rënë nga pozita e 59-të në pozitën e 62-të me një total prej 1382.69 pikë. Top-dhjetëshja ka mbetur e

pandryshuar nga emrat, por jo edhe nga pozitat. Argjentina vazhdon kryesimin, e ndjekur nga Franca e dyta, Anglia e treta, Belgjika e katërta dhe Brazili i pesti, pasi ka rënë për dy pozita. Pas tyre vjen Holanda e gjashta duke u ngritur një pozitë, Portugalia bie e shtata, Spanja mbetet e teta, derisa Italia e nënta dhe Kroacia mbyll dhjetëshen.



## Ramadani paraqitet te Drita: Synojmë titullin

Zekirija Ramadani është paraqitur të enjten në krye të skuadrës së Dritës. Ai menjëherë ka bërë me dije se synimi me skuadrën e re është titulli i kampionit në Superligë. “Me punë do ta ndjekim rrugën të cilën e ndjek Drita vitet e fundit, pra titullin e kampionit”, ka thënë Ramadani

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 30 NËNTOR** - Zekirija Ramadani është paraqitur të enjten në krye të skuadrës së Dritës nga Gjilani. “Kemi kënaqësinë t’ju njoftojmë që kemi arritur marrëveshje me trajnerin shkupjan Zekirija Ramadani. Ramadani është trajner i njohur në futbollin kosovar i cili ka fituar trofe me ekipet paraprahe dhe me kënaqësi ka pranuar ofertën e klubit. Klubi dhe Zeka kanë nënshkruar kontratë deri në fund të sezonit 2024/25 me mundësi vazhdimi edhe për një

sezon tjetër”, thuhet në njoftimin e skuadrës së Dritës. Optimizmi për sukses në konferencën për medie nuk i ka munguar trajnerit Ramadani, i cili edhe përkundër asaj që skuadra e tij e re është dhjetë pikë prapa skuadrës lidere në Superligë, Ballkanit dhe një ndeshje më shumë të zhvilluar, nuk ka hezituuar të tregojë se synim është titulli i kampionit. “Jam i lumtur që kam arritur marrëveshje me Dritën. Kisha vendosur të pushoja deri në stinorin pranveror, por jo gjithnjë të jepet mundësia të jesh trajner i Dritës. E di se secili koleg imi kish pasur dëshirë të



jetë në vendin tim. Falënderoj presidentët për besimin e dhënë dhe drejtorin i cili është merituar për ardhjen time këtu. Faktorë të rëndësishëm që unë pranova të vij te Drita janë klubi, serioziteti, objektivat, gjithsesi edhe kualiteti i futbollistëve. Kam besim te këta futbollistë. Me shumicën e tyre kam punuar në klubet e tjera, por edhe me të tjerët që nuk kam punuar i njoh

shumë mirë. Me punë do ta ndjekim rrugën të cilën e ndjek Drita vitet e fundit, pra titullin e kampionit”, ka thënë Ramadani, i cili më pas ka paralajmëruar se do të ketë ndryshime në skuadrën e Dritës. “Ndryshimi i trajnerëve bëhet për të ndryshuar diçka brenda klubit, përndryshe drejtuesit do të kishin vazhduar me të njëjtin trajner. Unë gjithmonë

mundohem t’u përshtatem futbollistëve që i kam dhe nuk jam trajner që jam rob i një moduli të lojës. Megjithatë, ndryshim patjetër se do të ketë në klub”, ka deklaruar ai.

I pyetur për dallimin e pikëve me Ballkanin, Ramadani është përgjigjur duke rikujtuar situatën pothuajse të njëjtë kur e mori drejtimin e Prishtinës: “Dua t’ju them një shembull. Në vitin 2020 me Prishtinën ishim minus 9 pikë dhe në vend të tretë kur përfundoi sezoni vjeshtor. Mirëpo tri xhiro para fundit u shpallëm kampionë. Normalisht se është një objektiv i vështirë, por besoj në punë dhe në seriozitetin e klubit”.

Trajneri Ramadani ka folur edhe për kohën e kaluar në skuadrën e Gjilanit. “Nuk merrem shumë me komente. Mbrëmë arrita marrëveshje dhe sot fillova punën me Dritën. Sa isha te Gjilani kam bërë punën time dhe kam dhënë maksimumin”, ka përfunduar Ramadani.

## ‘Dardanet’ mendojnë vetëm për fitore ndaj Bullgarisë



**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 30 NËNTOR** - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave sot (e premte) zhvillon përballjen ndaj Bullgarisë në kuadër të Ligës së Kombeve. Kjo ndeshje zhvillohet nga ora 11:30 në stadiumin “Zahir Pajaziti” në Podujevë dhe është shumë e rëndësishme për “dardanet”, pasi me fitore promovohen në Ligën B të Ligës së Kombeve. Futbollistja Edona Kryeziu ka deklaruar pas

stërvitjes ditën e enjte se Kosova është e vetëdijshme për rëndësinë e ndeshjes dhe se nuk po mendon asgjë tjetër përveç fitores. “Nga fillimi jemi fokusuar për t’i përmirësuar gabimet e ndeshjeve të kaluara në mënyrë që ta fitojmë këtë ndeshje. E dimë rëndësinë e kësaj ndeshje dhe nuk mendojmë për ndonjë rezultat tjetër përveç fitores. Me këtë fitore sigurojmë kalimin në Ligën B të Ligës së Kombeve, prandaj është ndeshje shumë e rëndësishme për ne. Jemi përgatitur maksimalisht dhe

shpresoj të dalim me fitore”, ka thënë ajo.

Për ndeshjen ndaj bullgareve ka folur edhe futbollistja tjetër Elizabeta Ejupi, e cila ka konfirmuar se në kampionatin e Kosovës ka një atmosferë të mirë dhe se janë gati për ndeshjen e sotme. “Jemi të emocionuara shumë për këtë përballje. Synimi është fitorja. Mezi presim ditën e ndeshjes. Kemi shikuar ndeshje të Bullgarisë, kemi bërë analizën me grupin dhe besoj se i kemi shikuar të gjitha gjërat për të qenë gati”, ka deklaruar ajo.

## Olimpisti Boraska viziton KOK-un

**PRISHTINË, 30 NËNTOR** - Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, ka pritur anëtarin e Komitetit Ekzekutiv të Shoqatës së Olimpistëve Botërorë, Igor Boraska. Kroati Boraska është medalist i

bronzitë në Lojërat Olimpike “Sidnej 2000” në “rowing” (shtyrje e varkës) si dhe kampion bote. “Qëllimi i vizitës së tij në KOK ishte formimi i Shoqatës së Olimpistëve në Kosovë, për çka presidenti

Krasniqi shprehu vullnetin dhe gatishmërinë e KOK-ut për të themeluar sa më parë këtë Shoqatë dhe për të bashkëpunuar ngushtë me Shoqatën e Olimpistëve Botërorë. Olimpisti Boraska

përgëzoi presidentin Krasniqi për sukseset e arritura, me theks të veçantë tri medaljet e arta olimpike, në vetëm dy pjesëmarrje në Lojërat Olimpike Verore”, thuhet në njoftimin e Komitetit Olimpik të Kosovës.



## Muja: Shqipëria nuk do të jetë si turiste në Gjermani

PRISHTINË, 30 NËNTOR - Arbnor Muja ka vetëm tre muaj që është bërë pjesë e Kombëtares shqiptare, por me natyrën e tij karizmatike dhe protagonist pas çdo ndeshje, duke festuar me nota patriotike, është bërë shumë i dashur për tifozët dhe

duket sikur është prej shumë kohësh pjesë e Shqipërisë. Anëtori i cili luan me Antwerpenin në Belgjikë, në një intervistë për "Telegrafi"-n ka thënë se kuqezinjtë nuk do të shkojnë vetëm si turistë në Gjermani. "Që tani kam marrë

qindra mesazhe nga familjarë, shoqëria e njerëz që i njoh për bileta. Gjermania do të pushtohet nga shqiptarët dhe do të jetë një kaos total, aq sa do të jenë në stadium, aq do të mbeten edhe jashtë, pasi sigurisht që numri do të jetë

shumë i madh. Ne nuk do të shkojmë si turistë në Gjermani. Pasi kemi fituar grupin në kualifikime, tani synimi i të gjithëve është të kalojmë edhe grupin në 'Euro 2024'. Jemi një popull që e duam shumë futbollin", ka deklaruar Muja.



## Pesë gara ndërkombëtare të basketbollit gjatë vitit 2024 në Kosovë

PRISHTINË, 30 NËNTOR - 2024 vjen në Kosovë me eventet më të mëdha të basketbollit ndërkombëtar. Më 08-09 qershor 2024 Prishtina do të jetë nikoqire e FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier, një garë kjo e rëndësishme e disiplinës 3x3, ku 15 shtete në të dyja konkurrencat do t'i matin forcat për të siguruar një vend në FIBA 3x3 Europe Cup, pra fituesit e FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier 2024 kualifikohen direkt në FIBA 3x3 Europe Cup të po njëjtë vit.

Kosova në këtë garë do të paraqitet me të dyja konkurrencat. Prej 25 deri më 30 qershor në Prishtinë, FBK-ja do të jetë për herë të parë organizatore e FIBA Kampionatit Evropian për Shtete të Vogla - Femrat, në të cilin Evropian do të marrin pjesë 8 shtete, ndërsa FBK ka filluar qysh tani të mobilizohet për të ndërtuar një skuadër, e cila do të ketë paraqitje dhe synime më të mëdha sesa në dy edicionet e para kur ka marrë pjesë në këtë garë.

Më 18 dhe 19 korrik klubi 3x3 Prishtina, në bashkëpunim me FBK-në, Ministrinë për Kulturë, Rinë e Sport dhe komunën e Prishtinës, do të jetë nikoqire e FIBA 3x3 Women's Series, kurse prej 20 deri më 21 korrik do të organizohet një tjetër event



prestigjioz si FIBA 3x3 Challenger Prishtina. Kjo është hera e dytë radhazi që këto gara i besohen klubit 3x3 Prishtina nga FIBA falë mbështetjes së madhe nga FBK. Edhe në këto gara Kosova do të paraqitet me të dyja konkurrencat. Qëllimi është që të rritet niveli i lojës për dallim nga ai i vitit 2023. Ngjarja e fundit që do ta organizojë FBK-ja në verën e vitit 2024 është FIBA U18 Kampionati Evropian, Divizioni C për Femra prej 23 deri më 28 korrik, në të

cilën garë do të marrin pjesë 8 shtete, kurse Kosova synon të ketë paraqitje dhe rezultate dukshëm më të mira sesa në verën e këtij viti. Duhet theksuar se FBK-ja prej vitit 2018 rregullisht është organizatore e garave të FIBA-s për FIBA Kampionatet Evropiane të Gjeneratave të Reja, ndërsa së fundi ka nisur t'i besohet edhe organizimi i aktiviteteve të 3x3 falë interesimit të madh të Federatës për ta zhvilluar këtë disiplinë në vendin tonë.

## Triumfojnë Denveri, lakersat, Toronto dhe clippersat



DENVER, 30 NËNTOR - Lakersat rikthehen te fitorja në NBA, duke mposhtur me rezultat 133-107 Detroitin jashtë fushës. Ndeshje e mirë për Russellin, autor i 35 pikëve, mbështetur nga Davisi me 28 pikë e Jamesi me 25. Skuadra e Orlandos mundi

Washingtonin (139-120), ndeshje ku dallimin në fushë e bëri Wagneri me 31 pikë. Zhgënjeu Philadelphia, që u mund nga New Orleansi (124-114), ndeshje me rivalitet shumicën e kohës. Maxey realizoi 33 pikë, por që s'mjaftuan, ndërsa për vendasit u

### Rezultatet

Detroit - Lakers	107-133
Orlando - Washington	139-120
Toronto - Phoenix	112-105
Memphis - Utah Jazz	105-91
New Orleans - Philadelphia	124-114
Denver - Houston	134-124
Sacramento - Clippers	117-131

dallua Williamsoni me 33 pikë. Fitonjë edhe clippersat, që falë 34 pikëve të Leonardos e 26 të Hardenit, mundën me rezultat 131-117 Sacramento. Kanadezët e Torontos mposhtën Phoenixin (112-105), një ndeshje me rivalitet deri në fund, ku dallimin e bëri kolektiviteti i ekipit vendës (6 lojtarë mbi 13 pikë). Kampionët e Denverit mundën Houstonin (134-124), ndeshje ku Jokiqi realizoi 32 pikë, 10 rebounde e 15 asistime, mbështetur nga Porteri me 30 pikë.

### SHKURT

#### Sot shorti i Kupës së Kosovës në futboll

Sot (e premte) do të bëhet tërheqja e shortit për rrethin e dytë të Kupës së Kosovës në futboll. Ndeshjet e këtij rrethi do të zhvillohen në mesjavën e ardhshme, më 5 e 6 dhjetor. Në këtë fazë marrin pjesë edhe klubet e Superligës dhe Ligës së Parë. Shorti tërhiqet në orën 11:00 në selinë e FFK-së në prani të Komisionit të Garave dhe përfaqësuesve të klubeve.

#### KH Besa iu rikthehet fitoreve

Kampionia në fuqi e Kosovës në hendboll, Besa Famgas, është kthyer te fitorja. Besa e Pejës e mposhti Vushtrrinë me rezultat bindës 38:25. Ndeshja e mbetur i takoi xhiros së parë. U zhvillua në Vushtrri. Besa Famgas mban vendin e dytë në tabelë me 18 pikë. Vushtrria është e shtata me dy pikë nga 11 ndeshje. Jon Vokshi ishte më efikas te Besa Famgas me 11 gola. Nga shtatë i shënuan Olsi Mulaj, Ajdin Smajlbegović dhe Ardit Tafilaj. Te Vushtrria tetë gola i shënoi Muhamet Hyseni. Lulëzim Sadiku i realizoi gjashtë. Në fundjavë, në kuadër të xhiros së 12-të, Besa luan në udhëtim te Trepça, ndërsa Vushtrria është mysafire e Rahovecit.

#### Shkarkohet Grosso

Fabio Grosso është shkarkuar nga bankina e Lyonit pas më shumë se dy muajsh. Rezultatet e dobëta dhe disfata e fundit kundër skuadrës së Edon Zhegrovës, Lilles, rezultuan fatale për italianin. Në tetë takime që ishte në krye të Lyonit, Grosso mundi të regjistronte vetëm një fitore si dhe tre barazime e katër disfata duke e lënë skuadrën në vendin e fundit të Ligës 1. Një tjetër aspekt që penalizoi teknikun 46-vjeçar ishte edhe pamundësia për ta menaxhuar grupin e veteranëve të përbërë nga kapiteni Lacazette, Lovren, Taljafiko e Tolisso. Në pritje të trajnerit të ri, skuadra do të drejtohet nga Pierre Sage, që është drejtor i qendrës stërvitore.

#### Bayerni heq dorë nga transferimi i Casemiros

Kampioni në fuqi i Gjermanisë, Bayern Munchen, nuk është interesuar për transferimin e Casemiros në afatin kalimtar të janarit, raporton "Sky Germany". 31-vjeçari nënshkroi një kontratë afatgjatë me Manchester Unitedin vetëm 18 muaj më parë nga Real Madridi, duke fituar një pagë të raportuar prej 350 000 eurosh në javë në "Old Trafford". Paga e tij e lartë dhe mosha e bëjnë thujtë të pamundur transferimin e lojtarit në "Allianz Arena".

#### Ten Hag: Luajtëm mirë kundër Galatasarayt

Manchester Unitedi barazoi kundër Galatasarayt (3-3) në ndeshjen dramatike që u zhvillua në Stamboll. Trajneri i Manchester Unitedit, Erik Ten Hag, është shprehur i kënaqur me paraqitjen e bërë nga skuadra e tij. "Jam i kënaqur se sa dinamik dhe i guximshëm ishte ekipi. Krijua shumë raste, veçanërisht në fund. Shanse të mëdha. Kemi luajtur futboll të mirë. Fajësoj veten nëse eliminohem. Dije që jemi në një projekt dhe po përmirësohemi. Jemi në drejtimin e duhur. E di ku duhet të shkojmë, çfarë hapash të ndërmarrim dhe jam i sigurt që do të kemi sukses afatgjatë, por nëse dëshiron të qëndrosh në Ligën e Kampionëve, duhet t'i fitosh këto ndeshje", ka thënë Ten Hag.



01.12.2023

Në bazë të nenit 17, paragrafi 3, pika 1 të Statutit të Kompanisë me Nr. 1/36 të dt. 20.04.2023, dhe në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 si dhe në bazë të nenit 4 të UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MPMS) NR. 07/2017, UD. Kryeshefi Ekzekutiv shpall:

**KONKURS**

**Titulli i pozitës së punës:** Makinist  
**Nr. referencë:** 01 - 01.12.23  
**Institucioni:** Hekurudhat e Kosovës-Trainkos-SH.A.  
**Tipi i Akt Emërimit të punës:** Orar të plotë pune  
**Titulli i mbikëqyrësit:** Shef i Njësisë së Personalit të Trenave  
**Kohëzgjatja e kontratës:** 1 (një) vit, me mundësi vazhdimi  
**Koeficienti/Kategoria:** K - V  
**Procedura e aplikimit:** I jashtëm  
**Vende të lira punë:** 3 pozitë (vend pune) Makinist  
**Vendi:** Fushë Kosovë  
**Qëllimi i vendit të punës:** Makinist

**Detrat dhe përgjegjësitë:**

- Pranon dhe verifikon gjendjen teknike të lokomotivës para nisjes për trenin e planifikuar
- Kontrollon dhe vërteton lokomotivën se a është e furnizuar me naftë, vaj, ujë, rërë dhe inventar;
- Bën manovra të nevojshme në oborr të deposë;
- Është përgjegjës për manipulimin me lokomotivë prej pranimit deri në dorëzim të saj;
- Përcjell dhe zbaton rregullat e sigurisë në trafik dhe udhëzimet tjera që janë të
- Udhëheqë formularët e nevojshëm (Et-1 dhe fletudhëtimin);
- Kryen urdhëresat e drejtuesve të trenave sipas urdhërave të shkruar;
- Siguron lokomotivat gjatë sezonit dimëror nga ngricat;
- Kryen provën e frenimit nëpër stacione të trenat pa personel shoqëruar
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit;

**Kushtet dhe kriteret, kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathtësitë e tjera:**

- Të këtë të kryer shkollën e mesme të lartë profesionale drejtimi tërheqje e trenave,
- Preferohet të ketë njohuri lidhur me programin e aftësimin profesional për makinist,
- Të dëshmoj grupen e I mjekësore,
- Të jetë i sjellshëm dhe komunikativ,
- Të jetë i aftë të punoj nën presion
- Preferohet të ketë përvojë pune në këtë lëmi.
- Perferohet të jete nën moshen 40 vjet
- Kërkohe patën shoferi kategoria B.

Aplikacioni dhe konkursi mund të merret në ndërtesën e Tërheqjes së Trenave në HK-Trainkos-SH.A apo në [www.trainkos.com](http://www.trainkos.com). Aplikacioni së bashku me dëshmitë të dorëzohen në ndërtesën e Tërheqjes së Trenave në HK-Trainkos-SH.A. në adresën Sali Puçolli Pn, në Fushë Kosovë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zarf të mbylltur, në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është më: **15/12/2023 ora 16:00**. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk i kthehen. Vetëm kandidatet e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.



01.12.2023

Na osnovu člana 17. stav 3. tačka 1. Statuta Društva sa br. 1/36 OD data 20.04.2023, a Na osnovu člana 8. Zakona o radu br. 03/L-212 kao i na osnovu člana 4 ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA (MPMS) BR. 07/2017, O.G Glavnog Izvršnog Direktora objavljuje:

**KONKURS**

**Naslov pozicije posla:** Mašinovoda

**Institucija:** Kosovske železnice-Trainkos – J.S.C  
**Eferentni broj:** 01 - 01.12.23  
**Vrsta Imenovanje Posla:** Potpuno radno vreme  
**Zvanje supervizora:** Šef Jedinice za vozno osoblje  
**Trajanje ugovora:** 1 (jedna) godina, sa mogućnošću produženja  
**Koeficijent/Kategorija:** K - V  
**Procedura prijavlivanja:** Eksterni konkurs  
**Vacanci:** 3 radno mesto (posao) Mašinovoda  
**Grad:** Kosovo Polje  
**Namena radnog mesta:** Mašinovoda

**Dužnosti i odgovornosti:**

- Pri prijemu na dužnost dolazi u dobrom fizičkom i zdravstvenom stanju.
- Prilikom dolaska na posao proverava i potpisuje knjige trajnog i privremenog karaktera
- Proverava ET 63 za potrebne popravke i potvrđuje da su one izbegnute.
- Prihvata i verifikuje tehničko stanje lokomotive pre polaska na predviđeni voz
- Proverava i verifikuje da li je lokomotiva snabdevena dizelom, uljem, vodom, peskom i inventarom;
- Prijem lokomotiva se vrši preko ET 76d.
- Vrš potrebne manevre u kompleksu M. lokomotiva i T. vozova.
- Odgovoran je za rukovanje lokomotivom od prijema do isporuke;
- Pridržava se i sprovodi pravila bezbednosti saobraćaja i druga uputstva
- Pripremiti potrebne formulare (Et-1 i putni list);
- izvršava naloge mašinovoda prema pismenim naložima;
- Osigurava lokomotive tokom zimske sezone od mraza;
- Obavlja test kočenja na železničkim stanicama bez pratećeg osoblja
- Zadatak predaje u dobrom fizičkom i zdravstvenom stanju, sačinjava zapisnik o obavljenom poslu.
- Obavlja druge poslove na zahtev supervizora;

**Uslovi i kriterijumi, kvalifikacija, radno iskustvo, veštine i druge veštine:**

- Da završi vuču voza za vuču voza više stručne škole,
- Poželjno je imati znanja vezana za program stručnog osposobljavanja za mašinstvo,
- Budite ljubazni i komunikativni,
- Biti sposoban da radi pod pritiskom
- Poželjno je da imate radno iskustvo u ovoj oblasti.
- Potvrde o zdravstvenoj ispravnosti za rad
- Poželjno je da budu žene od 40 godina
- Potrebna je vozačka dozvola B kategorije.

Prijava i konkurs se mogu dobiti u zgradi KZ-Trainkos-J.S.C ili na [www.trainkos.com](http://www.trainkos.com). Zahtev zajedno sa dokazima treba dostaviti u zgradu za vuču vozovau KZ-Trainkos-J.S.C. na adresi Sali Puçolli Bb, u Kosovu Polju. Dokumentaciju je potrebno dostaviti u zatvorenoj koverti, u kojoj mora biti upisano radno mesto za koje se prijavljujete. Poslednji rok za prijavu je: **15.12.2023 u 16:00** časova. Dokumentacija koja pristigne sa zakašnjenjem i nepotpuna smatraće se nevažećom.. Dokumente je potrebno dostaviti samo u kopijama jer se isti neće vraćati. Biće kontaktirani samo kandidati koji udu u uži izbor.

# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](https://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

---

# SWISS

## TAVERNA

---

Tel: +377 45 400 156    +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Spahe Ahmeti nga Batusha e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesat e kl.I,II,III,IV të sh.m.Mjekësisë “ Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Vjollca Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl.I sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë drejtimi Juridik.
- Arbnor Dervishaj shpall të pavlefshme dëftesat Q.K. “11 Marsi” Prizren.
- Naim Hasani shpall të pavlefshme diplomën Q.K.”11 Marsi” Prizren.
- Lavdim Ibrahim shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

